



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPITINA VUÇITEN
QD.Nr./Dr. <u>898/17</u>
No. i Dr. / Dr. nr. <u>-02-</u>
Dates / Datum <u>02.08.2017</u>
VUSHTRRI - VUÇITEN



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Participim: 31.07.2017**

Br. "Adem Jashari" nr. 1, tel. 088 571 524

**KOMUNA E VUSHTRRISË**

Duke u bazuar në nenin **17** pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me **Nr.03/L-040**, si dhe Thirrjes për Aplikim të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural me Nr: 09-007-37 të datës: 19.06.2017, lidhë këtë:

### **MARRËVESHJE ME PARTICIPIM** **(Për projektin "Makina Të Grurit")**

#### **E përpiluar në mes të:**

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Bajram Mulaku në njëren anë në cilësinë e subvencionuesit, dhe

2. Grupit të përfituesëve të makinave të grurit që kanë participuar për projektin e lartshënuar të cilën e përfaqësojnë me autorizim:

-Gazmend Selmani nga fsh.Druar me Nr.personal:1004735770

-Jahir Shala nga fsh.Samadrexhë me Nr.personal:1021317426

-Behxhet Muzaqi nga fsh.Brusnik me Nr.personal:1030045501

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në bujqësi.

#### **Neni 2**

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfituesëve të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mijeteve financiare të përfitueseve për realizimin e projektit "Makina për Grurë") në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionuese kryesor i projektit.

#### **Neni 3**

Vlera e përgjithshme e mijeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve të Serrave për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **4 000 €**.

#### **Neni 4**

4.1 Vlera e mijeteve që ka siguruar Komuna si investitor kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **20.000 €**, ndërkëq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **24.000€**

#### **Neni 5**

#### **Obligimet e Komunës**

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mijeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

### Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

### Neni 7

#### Obligimet e përfituesit

- 7.1. Përfituesi është i obliguar të paguajë shumën prej **500€**, në njëren llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrrisë.
- 7.2. Përfituesi është i obliguar që të përbahet marrëveshjes në përpikëri.
- 7.3. **Përfituesit/ses nuk i lejohet ta shesë, tjetërsojë ose ta keqpërdorë subvencionin, në të kundërtën do të ndiqet penalisht.**

### Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

### Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjtë do të realizohet me përbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

## P A L Ė T E M A R R È V E S H J E S


#### Investitori:

Konjuna e Vushtrrisë  
z.Bajram Malaku  
(Kryetar i Komunës)



#### Përfaqësuesit e përfitueseve të Makinave të Grurit :

- 1.Gazmend Selmani
- 2.Jahir Shala
- 3.Behxhet Muzaqi



## MARRËVESHJE PËR BASHKAPLIKIM DHE BASHKFINACIMI (MBF)

Në mes të

1. Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-Vushtrri e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Zenel Bunjaku me Nr regjistrimin: 5200122-6, NF:600019782 (në tekstin e mëtejmë i referuar si "IADK")  
Dhe
2. Komunës së Vushtrrisë e përfaqësuar nga z. Bajram Mulaku Kryetar i Komunës se Vushtrrisë (në tekstin e mëtejmë referuar si "Komuna e Vushtrrisë")

Neni 1  
Qëllimi

1. IADK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë, pajtohen të bashkëpunojnë me qëllim të përgatitjes për aplikim dhe zbatimin e projektit (nëse aprovohet nga BE-ja Projekt i në fjalë ) në thirrjen "Support to Vocational training, On-the-Job training, Self-Employment and Entrepreneurship" me vlerë rreth katërqind e njëzetë mijë (420,000.00) Euro, me kohëzgjatje 24 muaj për t'u financuar nga skema e granteve të EuropeAid/155035/DD/ACT/XK. Projekt do të përfshijë edhe komunat tjera të Regionit të Mitrovicës, nëse shprehin gatishmëri për bashkëplikim në thirrjen e lartcekur.

2. Kjo MBF është pjesë përbërse e propozimit për bashkëplikim, bashkëfinancim dhe kontribut mbështetës në realizimin e thirrjes "Support to Vocational training, On-the-Job training, Self-Employment and Entrepreneurship" me Nr: EuropeAid/155035/DD/ACT/XK.

Neni 2  
Obligimet e palëve

### 1. Obligimet e IADK-së

- 1.1 Pajtohet që të bëjë zbatimin e projektit dhe të gjitha aktivitetet e parapara në Komunën e Vushtrrisë sipas planit dhe dinamikës së tij.
- 1.2. Të angazhojë stafin edhe të njoftojë me kohë lidhur me ecurinë e realizimit të projektit në Komunën e Vushtrrisë, në mënyrë që të bëhet planifikimi dhe implementimi i tij.
- 1.3. Të mundësojë dhe të lehtësojë vizitat e përbashkëta dhe të sigurojë numër të mjaftueshëm të publikimeve për komunën.

### 2. Obligimet e Komuna së Vushtrrisë

- 2.1 Obligohen të bëjë bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej 20% të investimeve nga projekt i në Komunën e Vushtrrisë (e cila do të definohet pas përzgjedhjes se projektit si dhe aktivitetet që do të zbatohen në komunë në periudhën 2018 - 2019 në xhirologarinë 20-27-0000217128-84 në emrin IADK-së).

Adresa:  
Fshati Sfarraq i Ulët, p.n.  
42000 Vushtrri  
Kosovë

Të jetojmë nga toka dhu puna jemi!  
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org  
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726  
Web: www.iadk.org





2.2. Pajtohet të mbështesë procesin e zbatimit të projektit, për realizimin e të gjitha aktivitetave që zhvillohen në Komunën e Vushtrrisë.  
Të lehtësojë mbajtjen e trajnimeve këshillave përfituese dhe të marrë pjese atje ku është e mundur.

2.3. Monitoron realizimin e projekteve, zgjedhjen e përfituesve dhe përcjell përbushjen e obligimeve të tyre.

2.4. Të lehtësojë zbatimin e projektit sipas kritereve të përcaktuara për zgjedhjen e përfitueseve, më qëllim të përkrahjes së fermerëve.

**Neni 3  
Mbikëqyrja**

- Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje në rast të përsitimit të projektit, do të hartojnë marrëveshje për bashkëfinancim dhe realizimin e pjesës së projektit në Komunën e Vushtrrisë.
- IADK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë do të emërojnë nga një përfaqësues që të koordinojnë kontaktet e drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Zyrtaret do të përfshihen drejtpërdrejtë për realizimin e Projektit në afatin e përcaktuar kohor.
- Kjo MBF është e vlefshme vetëm nëse aprovohet projekt i Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

**Neni 4  
Numri i kopjeve**

Kjo MBF është hartuar në katër (4) kopje, ku secila palë merr nga dy (2) kopje.

**Neni 5  
Hyrja në fuqi**

Kjo MBF hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe konform nenit 3.2 të kësaj MBF-je.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)


Per:  
Z.Zenel Bunjaku, Drejtor Ekzekutiv

Vushtrri 03.08. 2017

Komuna e Vushtrrisë

Z.Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës

Vushtrri 03.08. 2017



## REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pikë 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "l" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe pas gjendjes së krijuar në teren nga zjarret, Kryetari i Komunës merr këtë:

### VENDIM PËR NGRITJE TË GATISHMËRISË EMERGJENTE

1. Ngritet gatishmëria emergjente dhe aktivizohet Qendra Lokale Emergjente në Komunën e Vushtrrisë pas gjendjes së krijuar në terren nga zjarret si dhe me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendje.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
3. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim - Qendrës Lokale Emergjente, Zyrës për informim, QKMF-së dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës  
Bajram Mulaku

 <b>REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA ZHOKOVI</b> <b>KOMUNA VUSHTRRI - KOMUNA VUSHTRRI</b>
<b>907/17</b> <hr/> Data / Date: <b>04. 08. 2017</b> <hr/> VUSHTRRI - VUSHTRRI



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pikë 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM  
PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E  
VUSHTRRISË**

- Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga zjarret të cilat kanë ndodhur në disa vendbanime në territorin e komunës, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:

- 1.1 Nezir Klinaku, Drejtor i DMSH-së, kryesues,
- 1.2 Mustafa Xhoni, DMSH, anëtar,
- 1.3 Gani Imeri, DSHP, anëtar
- 1.4 Abdullah Klinaku, DSHS, anëtar,
- 1.5 Betim Kollari, DI, anëtar,
- 1.6 Xhevrije Rama, DAdmin, anëtare,
- 1.7 Shpresa Rama, DKRS, anëtare,
- 1.8 Fadil Muzaqi, DProk. Anëtar,
- 1.9 Isuf Jashari, DFin. Anëtar,
- 1.10 Agim Miftari, DA, anëtar,
- 1.11 Arta Haxhaj, DEZH, anëtare,
- 1.12 Sami Istrefi, DUZH, anëtar,
- 1.13 Bedri Dobra, DKadas. Anëtar,
- 1.14 Bajram Beqiri, Zyrtar i DMSH, anëtar,
- 1.15 Blerim Zhabari, ZMedia, anëtar,
- 1.16 Fadil Hyseni, NJZ, anëtar,
- 1.17 Kumrije Zhabari, Kruqi i Kuq, anëtare,
- 1.18 Muhamet Alidemaj, PK, anëtar,
- 1.19 Shemsedin Preteni, Zëdhënës, anëtar,

- 1.20 Shefi i KEDS-it,
  - 1.21 Udhëheqësi i Ujësjellësit, Njësia në Vushtrri
  - 1.22 Luljeta Zahiti-Preteni, Drejtoresh e QKMF-së.
2. Qendra Emergjente (Shtabi emergjent) do të përcjellë 24 orë situatën në terren dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij përmes zyrës komunale për lajmërim, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, akter tjerë të ndërlidhur në këto situata emergjente.
  3. Drejtorët e drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.
  4. Zyra për informim të komunës të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
  5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRËS - OPITSA VUÇITIN	
Q. Nr. / Të	<u>908/17</u>
Nr. i Të / Zgj. #	
Dates / Datum	<u>04. 08.2017</u>
VUSHTRRI - VUÇITIN	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67.1 shkronja (g) të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në kërkesën nr.05/138 të datës 04 gusht 2017 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryetari i Komunës me datën 04 gusht 2017 merr këtë:

### V E N D I M

- Lejohet kompensimi i shujtave për 55 – 60 persona prej datës 04 gusht 2017 deri në përfundimin e gjendjes emergjente, të shpallur si rezultat i përhapjes së zjarreve në Komunën e Vushtrrisë.
- z. Bajram Beqiri – zyrtar i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, autorizohet që të siguron furnizimin (tërheqjen) e shujtave të përmendura si në pikën 1 të këtij Vendimi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe Drejtoria për Prokurim.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Nga një (1) kopje e këtij Vendimi i dërgohet:  
 -Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
 -Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;  
 -Drejtoria për Prokurim;  
 -Arkivit.

REPUBLIKA KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA VUSHTRRI - MUNICIPALITY	
02 Nr. / 00	<u>927/17</u>
No. 176 / 2017	
Ditë / Datum	<u>10.08.2017</u>
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturave: nr.2754, dt. 30.06.2017, në shumë prej 451,40 € (katërqindëpesëdhjetëënjëeuro e katërdhjetë cent), dhe nr. 2763, dt. 04.07.2017 në shumë prej 105,00 € (njëqindëpesë euro) për shpenzimet e krijuara në NH "Amazona", Muzakaj, Obiliq, (akomodim dhe drekë) me mysafir nga të gjitha trojet shqiptare, me rastin e mbajtjes së konferencës shkencore kushtuar heroinës Shote Galica.
2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në llogarinë bankare të paraqitur në faturat të cilat janë të bashkëngjitura në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

Prishtinë, datë, 07.08.2017

Bazuar në përgjegjësitë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të përcaktuara me Rregulloren Qeveritare Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe shtojcën XII, si dhe nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhet:

### **MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT**

**Për bartjen e pronësisë dhe vendosjen në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë pajisjet e teknologjisë informative “TELEPREZENCA”**

**Palët nënshkruese:**

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme znj. Rozafa Ukimera, (në tekstin e mëtejmë MAPL), dhe
2. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Bajram Mulaku, (në tekstin e mëtejmë Komuna)

**Neni 1**  
**Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit, është përkrahja e Komunës së Vushtrrisë me pajisje të teknologjisë informative dhe komunikuese, me qëllim të përbushjes së detyrimit ligjor të MAPL-së me rastin e monitorimit të seancave të Kuvendeve të Komunave, me një kosto të ulët financiare, si dhe i mundëson një komunikim më të avancuar me të gjitha strukturat kommunale duke përfshirë këtu edhe mundësinë e mbajtjes së takimeve sipas agjendave të rregullta me kryetarët, kryesuesit, drejtoret e administratës dhe strukturave tjera lokale.

Gjithashtu, bazuar në përparësitë që ka shfrytëzimi i këtyre pajisjeve, komunave ju garantohet komunikim i avancuar me institucionet qendrore, ju jepet më tepër mundësi që ato të

komunikojnë me bizneset dhe partnerët e projekteve publiko-private jashtë komunës, si dhe ju mundëson avancim të komunikimit dhe të bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar dhe ndërkombetar.

### **Neni 2 Objekt i Marrëveshjes**

1. Objekt i kësaj marrëveshje janë pajisjet e posaçme të teknologjisë informative dhe komunikuese, të cekura si në vijim:
  - 1.1 Kamera 3D Polycom CX 5100 (1 copë);
  - 1.2 Mikrofon Polycom të integruar në kamerë (3 copë);
  - 1.3 Kabllo të rrymës dhe kabllot përcjellëse për furnizim dhe optimizim të përbajtjes – video/audio (1 copë);
  - 1.4 Manuali.
2. Këto pajisje janë financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
3. Pranim-dorëzimi i pajisjeve nga Divizioni i Logistikës së MAPL-së tek Komuna, bëhet përmes zyrtarëve të TI-së së Komunës përkatëse.

### **Neni 3 Fushëveprimi**

1. Pajisjet e teknologjisë informative të përshkruara në nenin 2 të kësaj marrëveshje, do t'i dhurohen Komunës për:
  - 1.1 Lehtësimin e procesit të monitorimit të mbledhjes së Kuvendit nga MAPL;
  - 1.2 Lehtësimin e mbajtjes së mbledhjeve të MAPL-së me kryetarët e komunave në distancë me: Kryetarët e Komunave, Kryesuesit e Kuvendeve, Drejtoret e Administratës dhe strukturat tjera lokale,
  - 1.3 Mbajtjen e mbledhjeve të kryetarëve të komunave ndërmjet vete.
  - 1.4 Komunikimin me shtetet e jashtme (me komunat tjera të shteteve tjera që kanë lidhur marrëveshje të binjakëzimit, bashkëpunimit ndërkufitar ose bashkëpunimit ndërkomunal-ndërkombetar).

2. Pajisjet i dedikohen Komunës, ndërsa menaxhohen nga Drejtori i Administratës.

**Neni 4**  
**Obligimet e Komunës**

1. Komuna pranon që ka marrë në pronësinë e saj pajisjet e përshkruara më larte, në kushte të *mirë funksionale*:
2. Çështjet që kanë të bëjnë me funksionalitetin e pajisjeve të përshkruara në nenin 2 të kësaj marrëveshje janë të mbuluara me garacionin dhe do të adresohen drejtpërdrejt nga komuna tek operatori ekonomik "STORM - ICT" LL.C (shitësi).
3. Zyrtari i TI-së duhet të sigurojë nga një port RJ 45 që lidhet në rrjetin qeveritar dhe furnizim me rrymë në:
  - 3.1 Në sallën e Kuvendit të Komunës pranë tavolinës së Kryesuesit të Komunës;
  - 3.2 Në zyrën e Kryetarit te Komunës;
  - 3.3 Në zyrën e drejtorit të administratës.
4. Zyrtari i TI-së vendos (1) mikrofon para kryesuesit, ndërsa mikrofoni tjetër ndërlidhet me sistemin e zërimit të sallës.
5. Komuna për teleprezencë duhet ta dedikoj një (1) laptop në të cilin janë të instaluara:
  - 5.1 Sistemi operativ MS Windows 7/8/10;
  - 5.2 MS Office 2013 ose 2016;
  - 5.3 Lync 2013 ose Skype for businnes 2015;
6. Gjatë takimeve të drejtpërdrejta komunat përdorin llogarinë e formës [vc.komuna@rks-gov.net](mailto:vc.komuna@rks-gov.net) e cila llogari menaxhohet nga zyrtari i TI-së së komunës përkatëse.
7. Komuna obligohet që pajisjet e dhuruara ti përdorë për nevojat dhe shërbimet e komunës.
8. Pas përfundimit të garacionit (periudha 3 vjeçare e përdorimit), Komuna do të sigurojë buxhet për mirëmbajtjen adekuate të pajisjeve të TI-së të parashikuara në nenin 2 të kësaj marrëveshje.

**Neni 5**  
**Mbikëqyrja**

1. Për çështje sistemore të teleprezencës kompetente është Komuna, ndërsa për anën permbajtësore dhe monitoruese është MAPL.


2. Pajisjet e teknologjisë informative dhe komunikuese që janë objekt i kësaj marrëveshje, evidentohen si pronë e Komunës, si dhe të njejtat duhet të tregohen çdo herë kur kërkojen nga zyrtarët e MAPL-së, se a janë duke u përdorur për qëllimin e duhur.

**Neni 6**  
**Numri i kopjeve**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit, do të bëhet në 2 kopje identike, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

Rozafa Ukimeraj  
  
Sekretare e Përgjithshme, MAPL





REPUBLICA E KOROVES - REPUBLICA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRRISË - OPATUA VUÇTRI
02 Në. f.Dc.	942/17
No. i ligj / No. st	-2-
Dates / Dates	16. 08. 2017
VUSHTRRI - VUÇTRI	



Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Obiliqit

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI  
PËR  
REALIZIMIN E PROJEKTIT "PASTRIMI I SHTRETËRVE TË LUMENJVE SITNICË DHE LLAP"**

E lidhur në mes të

1. Komunës së Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Bajram Mulaku, dhe  
dhe
2. Komunës së Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Xhafer Gashi.

Neni 1  
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është pastrimi i shtretërve të lumenjve "Silnicë dhe Llap" në territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe të Komunës së Obiliqit, në mënyrë që të evitojen rreziqet eventuale nga vërvshimet në territoret e komunave në fjalë.

Neni 2  
Obligimet e palëve

**1.Obligimet e Komunës së Obiliqit**

- 1.1. Hartimin e projektit për pastrimin e shtretërve të lumenjve "Silnicë dhe Llap" në territorin e Komunës së Vushtrrisë ( për Silnicën, nga kufiri administrativ Obiliq-Vushtrri deri tek Ura e Prilluzhës) dhe territorin e Komunës së Obiliqit.
- 1.2. Pastrimin e shtratit të lumit "Silnicë" brenda territorit të Komunës së Obiliqit dhe në territorin e Komunës së Vushtrrisë (duke filluar nga Ura e fshatit Prelluzhë deri në vijen ndarëse administrative me Komunën e Obiliqit).
- 1.3. Mbulon shpenzimet e realizimit të projektit për pastrimin e shtratit të lumit "Silnicë", si dhe të udhëheqë të gjitha procedurat për realizimin e projektit.

**2.Obligimet e Komunës së Vushtrrisë**

- 2.1. Pastrimin e shtratit të lumit "Llap" në territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe në territorin e Komunës së Obiliqit.
- 2.2. Tenderimin për realizimin e pastrimit të shtratit të lumit "Llap", duke përfshirë sigurimin e mjeteve financiare nga Fondi "Projektet për bashkëfinancim me donatorë ", për vitin 2017.



Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Obiliqit

**Neni 3  
Obligimet e përbashkëta**

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje obligohen të bëjnë mbikëqyrjen e realizimit të projektit që i përket territorit të Komunës së Vushtrrisë dhe të territorit të Komunës së Obiliqit, duke caktuar nga një anëtar në cilësinë e organit mbikëqyrës.

**Neni 4  
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët nënshkruese do të angazhohen që mosmarrëveshjet eventuale të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast të dështimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore, kontestet do të zgjidhen në gjykatën kompetente në bazë të legjislacionit në fuqi.

**Neni 5  
Numri i ekzemplarëve**

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) ekzemplarë, ku secila palë merr nga dy (2) ekzemplarë.

**Neni 6  
Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Nënshkuar më 16.08.2017

Palët nënshkruese:

**Komuna e Obiliqit**

z. Xhafer Gashi



**Komuna e Vushtrrisë**

z. Bajram Mulaku





REPUBLIKA E KOSOVËS	KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËTINA VUÇITRNI
03 Nr./Dc	943/17
No. i Dq. / Bll. nr.	
Datum / Date	16.08.2017
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**Data e nënshkrimit të Marëveshjes me Participim: 16.08.2017**

Rr. "Adem Jashari" nr. 1, tel. 038 571 824

**KOMUNA E VUSHTRRISË**

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me **Nr.03/L-040**, si dhe Njoftimit të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me Nr.09-007-71 të datës: 26.08.2016, lidhë këtë;

### **MARËVESHJE ME PARTICIPIM** (Për projektin Ngritje të pemishtes "Mollë")

#### **E përpiluar në mes të:**

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Bajram Mulaku në njëren anë në lidhje e subvencionuesit, dhe
2. Grupit të përfitueseve të pemëtarisë(mollës) që kanë participuar për projektin e lartshënuar të cilën e përfaqësojnë me autorizim:
  - Jetullah Baliu nga fsh.Novolanë me Nr.personal:1015543015
  - Sabri Haradinaj nga fsh.Stanocë i Epërm me Nr.personal:1013937377
  - Isuf Imeri nga fsh.Vushtrri me Nr.personal:1021046481

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e plantacioneve në pemëtar.

#### **Neni 2**

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i grupit të përfitueseve të pemishtes të Komunës së Vushtrrisë, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfitueseve për realizimin e projektit pemëtar, në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionues kryesor i projektit.

#### **Neni 3**

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfitueseve të pemishtes për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **2 367.00€**.

#### **Neni 4**

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si investitor kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **40,000.00 €**, ndërsa që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **42,367.00€**

#### **Neni 5**

#### **Obligimet e Komunës**

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit e pemishtes të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

### Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

### Neni 7

#### Obligimet e përfituesit

- 7.1 Përfituesit janë të obliguar që secili të paguajë shumën prej 263€ në llogari të caktuar bankare të Komunës së Vushtrisë.
- 7.2 Përfituesit janë të obliguar që të rregullojnë hapësirën ku do të vendoset pemishtja.
- 7.3 Hapësira duhet të jetë e pastër të ketë ujë dhe ndricim të mirë.
- 7.4 Përfituesit nuk i lejohet ta shesë, tjetërsoje ose ta keqpërdor projektin e lartcekur, në të kundërtën do të ndiqet penalisht.**

### Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset:Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

### Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjtë do të realizohet me përbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

## P A L Ë T E M A R Ë V E S H J E S

**Komuna e Vushtrisë**

Z. Bajram Mulaku  
Kryetar i Komunës



#### Përfaqësuesit e përfitueseve të Pemishtes:

- 1.Jetullah Baliu
- 2.Sabri Haradinaj
- 3.Ilsuf Imeri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUÇITRNI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- Në mungesë të mjetave financiare në Njësinë e Zjarrfikësve, kategoria mallra dhe shërbime, lejohen mjetet financiare në shumë prej 3780.00 € (tremijëeshtatqindetëdhjetë euro) nga buxheti i Drejtorisë për Shërbime Publike në Vuçitrri (mallra dhe shërbime) të cilat do të shfrytëzohen për servisim të automjetit zyrtar të Njësisë së Zjarrfikësve në Vuçitrri, sipas specifikacionit në kërkesën (e NJZ) dt. 21.08.2017, të bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet Financa.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
- Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Shërbime Publike si dhe Arkivit të Sekretarisë.



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VUSHTRRI - OPËTINA VUSHTRRI	
Ref. / Br.	975/17
Ne / Ng. / Dc. et	
Data: / Datum:	22. 08. 2017
VUSHTRRI - VUHTRRI	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- Lejohet pagesa e faturës nr.0025339, dt. 24.07.2017, në shumë prej 148.10 € (njëqindkatërdhjetëtetë euro e dhjetë cent), për shpenzimet e krijuara në NPH "6 Vllëzërit Istrefi" në Vushtrri, me rastin e vizitës së Ambasadorit të SHBA-së në Kosovë me bashkëpunëtorë.
- Pagesa të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës në llogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
- Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA VUÇITRNI - OPŠTINA VUÇITRN
REK N. / REK / 982/17
Nr. I Dq. / Bo. #
Date / Datum: 23.08.2017
VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në pikën "b" të nenit 5 të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M  
PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES**

1. Formohet grupi punues për bashkërendim të aktiviteteve në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe GIZ-it për realizim të pilot projektit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.
2. Grupi punues ka këtë përbërje:
  - 2.1 Islam Latifi
  - 2.2 Bajram Beqiri
  - 2.3 Ilirijana Azemi
  - 2.4 Idriz Ismajli
  - 2.5 Abit Abiti
  - 2.6 Arben Mlinaku
  - 2.7 Blerim Zhabari
3. Grupi punues do të jetë përgjegjës për çështjet që janë të përfshira në Memorandum të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Anëtarëve të grupit punues dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUSHTRRI	
02 NATE / 01	991/17
NE: 136.714-01	
Datum / Datum:	28. 08. 2017
VUSHTRRI - VUÇITRI	



## REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në pikën "b" të nenit 5 të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES

1. Formohet gripi punues për bashkërendim të aktiviteteve në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe GIZ-it për realizim të pilot projektit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.
2. Gripi punues ka këtë përbërje:
  - 2.1 Islam Latifi, Drejtoria e Shërbimeve Publike
  - 2.2 Bajram Beqiri, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
  - 2.3 Arta Haxhaj, Drejtoria për Ekonomi Bujqësi dhe Zhvillim rural
  - 2.4 Ilirijana Azemi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - 2.5 Idriz Ismajli, Zyra e Kryetarit
  - 2.6 Abit Abiti, Zyrtar Kryesor Financiar
  - 2.7 Arben Mlinaku, Drejtoria e Shërbimeve Publike
  - 2.8 Blerim Zhabari, Zyra për Informim
  - 2.9 Haki Shabani, KRU "Uniteti", Njësia në Vushtrri
3. Gripi punues do të jetë përgjegjës për çështjet që janë të përfshira në Memorandum të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 982/17, dt. 23.08.2017.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi ju dërgohet: Anëtarëve të grupit punues dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës  
Bajram Mulaku